



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2024.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe ministritë për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. të këtij Vendimi t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-013 për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 100 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I propozohen Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për pozitën e një (1) anëtari të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit si në vijim:
 - Znj. Batisha Ibrahim;
 - Z. Meriton Zika.
- Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë e kandidatëve të propozuar t'ia procedoj për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike, Kompania Rajonale e Ujitjes Drini i Bardhë Sh. A. Pejë, emëron këta kandidatë:
 - Znj. Arjeta Zeka, kryesuese;
 - Z. Ilaz Halili, anëtar;
 - Z. Shkodran Gaxherri, anëtar;
 - Znj. Zamire Deçani-Beqiri, anëtare;
 - Znj. Rina Sylafeta-Kumnova, anëtare;
 - Z. Besim Kajabegolli, anëtar.
- Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
- Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/81 të datës 1 qershor 2022

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për dy (2) pozitat e drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina Sh. A. Prishtinë, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Bashkim Pllana, kryesues;
 - 1.2. Z. Fatos Budeci, anëtar.
2. Kryesuesi i caktuar sipas Vendimit të Qeverisë Nr.08/81 të datës 1 qershor 2022, vazhdon të mbajë pozitën e anëtarit të ndërmarrjes.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 08/81 të datës 1 qershor 2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Vendimit të Qeverisë Nr. 07/145 të datës 7 qershor 2023 për aprovimin e Manualit për vlerësimin Ex - post të akteve juridike në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Vlerësimin Ex-post të akteve juridike të Republikës së Kosovës për vitin 2024.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për koordinimin e procesit të vlerësimit Ex - post me ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore P. Sh. IGK "Ballkan" Njësia Damper, (ish Kampi "Casablanka"), për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, Zona Kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mbrojtjes.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit "Marrëveshje Kornizë e Partneritetit për Mbështetje me Vaksina dhe\ose Para të Gatshme" ndërmjet Aleancës GAVI dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI) për Projektin "Energjia Diellore Fotovoltaike në KEK – Porta Globale".
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi për Kapitalin Njerëzor të Kosovës".
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Peshkatari dhe Akuakulturë.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Disiplinën e Nëpunësve Civil.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Transferimin e Nëpunësve Civil.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 2 paragrafit 2.3 dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, nenit 12 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa me Nr. prot. 439 e datës 22 janar 2024 e Ndërmarrjes Publike "Trepça" Sh. A. për marrje në shfrytëzim të pronës së ngastrës kadastrale me Nr. 3129 Kostin Potok, Majdevo - Leposaviç, pronar Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila menaxhohet nga Agjencia Pyjore e Kosovës.
2. Ngastra kadastrale me Nr. 3129 i jepet në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike "Trepça" Sh. A. sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Obligohet Agjencia Pyjore e Kosovës dhe N. P. "Trepça" Sh. A, për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në zbatim të paragrafit 9. të nenit 46 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e 375 (treqindeshtatëdhjetepesë) specializantëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nën programi Aftësimi Specialistik dhe EVM me kod 90300, në vlerë 3,292,045.00€ (tre milionë e dyqindënëntëdhjetedy mijë e dyzetepesë euro) prej datës 1 janar deri 31 dhjetor 2024.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/186
Datë: 24.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 36, paragrafi 4. të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e 21 (njëzetënjë) specialistëve me vetëfinancim nga Lugina e Preshevës, Mali i Zi, nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nën programi Aftësimi Specialistik dhe EVM kod 90300, në vlerë 221,760.00€ (dyqindënjëzetënjë mijë e shtatëqindëgjatëdhjetë euro), prej datës 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë